

Prezentojmë

ITALIANËT DHE SHQIPTARËT

Një partneritet historik

Për më se 500 vjet, shqiptarët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e Italisë së Jugut. Në vitin 1443 Mbreti Alfons i Napolit kërkoi ndihmën e ushtrisë shqiptare për ta ndihmuar atë për të mundur një kryengritje të rebelëve në Napoli që përfshinte edhe francezet të cilët kishin pretendime për mbretërinë e tij. Si shpërblim, Mbreti Alfons e emëroi Guvernator të Kalabrisë gjeneralin shqiptar Demetrios Reres, i cili udhëhoqi me sukses ofensivën dhe u dha tokë shqiptarëve në zonën malore në Cantazaro.

Në vitin 1461, Mbretërisë së Napolit përsëri ju desh ndihmë nga ushtria shqiptare. Këtë herë udhëheqësi legjendar Gjergj Kastrioti (Skënderbeu) udhëhoqi ushtrinë e tij me mbi 4000 ushtarë nga deti Adriatik në Itali për ta shtypur një kryengritje tjetër të përkrahur nga francezët. Ushtarët dhe kalorësit e zotë të Skënderbeut fituan “Betejen e Pulias” dhe shpëtuan Mbretërinë e Napolit. Si shpërblim atyre iu dha tokë në afërsi të Ariano Irpino në provincën e sotme të Avelinos, që përfshinte edhe një fshat të vogël grek, që merrej me bujqësi dhe tregti që quhej Greci.

Suksesit të Skënderbeut dhe ushtrisë së fuqishme shqiptare i erdhi fundi, atherë kur Skënderbeu vdiq nga pneumonia në vitin 1468 pasi luftoi për 27 vjet me radhë kundër Turqve Osmanë. Ushtarët e tij që kishin mbetur në Greci nuk u kthyen në Shqipëri, e cila si shumica e Ballkanit ishte pushtuar dhe ishte nën sundimin e Turqve Osmanë. Për 450 vjet, Shqipëria dhe shqiptarët do të vuanin nga sundimi Turk, gjë që nuk ndodhi në Gadishullin Italian dhe Evropën Përendimore. Si mirënjohje ndaj Skënderbeut dhe ushtarëve të tij Mbretëria e Napolit u bë një venbanim i përhershëm i shqiptarëve.




Që nga fillimi i vitit 1448, shqiptarët emigruan në gadishullin Italian në kërkim të lirisë nga sundimi Turk dhe konvertimit me forcë në fenë Islame. Gjatë kësaj kohe dhe periudhave të emigrimit të shqiptarëve që do të pasonin, u formuan shumë fshatra shqiptare në Kalabri, Basilikata, Brindisi dhe Sicili. Emigrantët e rinjë zakonisht punonin si mercenarë të paguar nga ushtritë “Italiane” deri më 1861 kur u themelua Republika Italiane. Gjatë shekujve shumë shqiptaro-italianë të spikatur si Francesco Crispi, i cili iu bashkangjiti Garibaldi në krijimin e Italisë dhe më vonë më 1887 u bë kryeministër, kanë kontribuar në zhvillimin e jetës dhe kulturës italiane.

Shumë fshatra shqiptare që flasin shqip ekzistojnë ende në Italinë e Jugut dhe mëse 100.000 shqiptarë në Itali ende flasin gjuhën shqipe në formën originale të saj me fjalë të shtuara nga italishtja që quhet “Arbëreshe”, e cila flitet dhe dëgjohet në 51 fshatra shqiptaro-italiane si Greci, Civita, Barile dhe shumë qytete dhe fshatra afër Kozencës.

Italia moderne e ka vazhduar partneritetin historik mes Italianëve dhe Shqiptarëve. Ajo që vlen për tu përmendur në 1991 me rënien e komunizmit në Shqipëri dhe në 1998-1999 gjatë luftës dhe genocidit që Serbia e shkaktoi në Kosovë, Italia përsëri hapi dyert për mijëra shqiptarë refugjatë. Shumë nga këta refugjatë më vonë u kthyen në Shqipëri dhe Kosovë, kurse ata që nuk u kthyen, ndihmuar në forcimin e shqiptarëve etnikë në Itali dhe do të vazhdojnë të jenë pjesë vitale e kombit Italian për shekuj me radhë.

Qyteteza dhe Fshatra Shqiptare në Italinë e Sotme



Zonat me ngjyrë të kuqe tregojnë se ku jetojnë shqiptarët në Ballkan

Pikat e kuqe në hartë tregojnë vendodhjen e 51 fshatrave dhe qyteteve shqipfolëse në Italinë e sotme

Lista sipas alfabetit të qyteteve dhe fshatrave shqip folëse (Arbëreshe) në italinë e sotme:

ABRUZZO

- Province of Pescara
 - Villa Badessa: *Badhesa*

MOLISE

- Province of Campobasso
 - Campomarino: *Këmarini*
 - Montecilfone: *Munxhufuni*
 - Portocannone: *Portkanuni*
 - Ururi: *Rûri*

CAMPANIA

- Province of Avellino
 - Greci: *Katundi*

APULIA

- Province of Foggia
 - Casalvecchio di Puglia: *Kazallveqji*
 - Chieuti: *Qefti*
- Provincia di Taranto
 - San Marzano di San Giuseppe: *Shën Marcani*

BASILICATA

- Province of Potenza
 - Barile: *Barilli*
 - Ginestra: *Zhura*
 - Maschito: *Mashqiti*

- San Costantino Albanese: *Shën Kostandini Arbëresh*
- San Paolo Albanese: *Shën Pali Arbëresh*

CALABRIA

- Province of Catanzaro
 - Andali: *Andalli*
 - Caraffa di Catanzaro: *Garafa*
 - Marcedusa: *Marçëdhuza*
 - Vena di Maida: *Vina*
- Province of Cosenza
 - Acquaformosa: *Firmoza*
 - Cantinella: *Kantinela*
 - Cerzeto: *Qana*
 - Castrolibero: *Kastërnexhi*
 - Cavalerizzo: *Kajverici*
 - Civita: *Çifti*
 - Eianina: *Purçill*
 - Falconara Albanese: *Fullkunara*
 - Farneta: *Farneta*
 - Firmo: *Ferma*
 - Frascineto: *Frasnita*
 - Lungro: *Ungura*
 - Macchia Albanese: *Maqi*

- Marri: *Allimarrì*
- Mongrassano: *Mungrasana*
- Plataci: *Pllatëni*
- San Basile: *Shën Vasili*
- San Benedetto Ullano: *Shën Benedhiti*
- Santa Caterina Albanese: *Picilia*
- San Cosmo Albanese: *Strihàri*
- San Demetrio Corone: *Shën Mitri*
- San Giorgio Albanese: *Mbuzati*
- San Giacomo di Cerzeto: *Shën Japku*
- San Martino di Finita: *Shën Mërtiri*
- Santa Sofia d'Epiro: *Shën Sofia*
- Spezzano Albanese: *Spixana*
- Vaccarizzo Albanese: *Vakarici*

-Province of Crotona

- Carfizzi: *Karfici*
- Pallagorio: *Puhëriu*
- San Nicola dell'Alto: *Shën Kolli*

SICILIA

- Province of Palermo
 - Contessa Entellina: *Kundisa*
 - Piana degli Albanesi: *Hora e Arbëreshëvet*
 - Santa Cristina Gela: *Sëndahstina*

GRECI: Fshati më i vjetër shqiptar në Itali

Themeluar më 1461



COMUNE DI GRECI

Provincia di Avellino



Greci i shtrirë në maje të kodrave në provincen italiane Avelino

Rreth 40 milje në juglindje të Napolit, Greci shtrihet në pjesën më veriore dhe është qyteti më i vjetër nga të 51 qytezat dhe fshatrat shqipfolëse në Italinë e sotme, i themeluar në vitin 1461 nga ushtarët e Gjergj Kastriotit që luftuan me te për të shpëtuar Mbretërinë e Napolit në betejën e famshme të Pulias.

Ishte ajo kohë kur qindra mijëra shqiptarë morën arratinë nëpërmjet detit Adriatik për të shkuar në Mbretërinë e Napolit dhe më gjerë për të kërkuar lirinë nga sundimi turk dhe konvertimin me forcë në fenë islame. Përveç Grecit, ata themeluan edhe 50 fshatra të tjera shqipfolëse që lulëzuan dhe u zhvilluan deri në ditët e sotme në Campania, Puglia, Sicilia dhe Calabria. Refugjatët shqiptarë që u quajtën Arbëresh i ruajtën traditat, kulturën dhe gjuhën shqipe si dhe trashëgiminë katolike gjatë pushtimit Otoman të tokave shqiptare që zgjati për 425 vjet.

— Shirley Cloyes DioGuardi

GRECI DHE SHPËTIMI SHQIPTAR I GADISHULLIT ITALIAN



**Nga Shirley
Cloyes DioGuardi**

Historia e Grecit është ngushtë e lidhur me rolin vendimtar të udhëheqësit historik shqiptar Gjergj Kastrioti (Skenderbeut) për të shpëtuar Gadishullin Italian dhe pjesën tjetër të Evropës Përdimore nga sundimi i Perandorisë Turke Otomane në shekullin e pesëmbëdhjetë. Kjo është arsyeja pse Gjergj Kastrioti është një figurë madhështore e shekullit të pesëmbëdhjetë jo vetëm për shqiptarët por për të gjithë evropianët dhe vepra e tij është e pavdekshme.

Një gjeni ushtarak, filozof, zotërues i disa gjuhëve të huaja, diplomat dhe katolik i devotshëm, Kastrioti ka qenë në qendër të disa librave në shumë gjuhë, poemave nga Longfellow dhe Lordi Bajron si dhe një opera nga Vivaldi. Statujat e kësaj figure ikonike me shpatë në dorë dhe kalin e tij të magjishëm i janë dedikuar atij dhe vendosur në Romë, Vienë dhe Budapest. Historia që fillon në Shqipëri dhe përfundon në Greci.

Kastrioti ishte i biri i një princi shqiptar Gjon Kastrioti i cili i zbrapsi Turqit Otoman për më se 20 vite, derisa ai dhe udhëheqës të tjerë shqiptar u detyruan të nënshkruajnë një traktat paqe të rremë në 1422 me Sulltan Muratin II për zbrapsjen e ushtrisë turke nga Europa juglindore dhe për shpëtimin e jetëve të njerëzve të tij nga kthetrat e sundimit Otoman. Për të garantuar këtë marreveshje, Sulltani i mori të katër djemtë e Gjonit peng dhe i dërgoi ata në Akademinë Ushtarake Otomane në kryeqytetin Adrianopojë. Përgatitja e jashtëzakonshme akademike dhe të dhënat ushtarake të djalit të tit e vogël, Gjergj, tërhoqën vëmendjen e Sulltanit i cili i dha gradën e Gjeneralit dhe titullin e nderit “Skender Bej” në moshën 19 vjeçare për nder të Aleksandrit të Madh.

Në 1443, Skenderbeu i erdhi lajmi se babai i tij kishte vdekur në qytetin e tij në Krujë në Shqipëri. Meqë Gjoni ishte udhëheqës i njohur shqiptar kundër Otomanëve, Skenderbeu e nuhati rezikun

për të hequr shqiptarët. Ai gjeti momentin kur u dërgua në një shërbim ushtarak për të luftuar kundër Hungarezëve të cilët udhëhiqeshin nga një tjetër luftëtar i madh (dhe i rrezikshëm për Sulltanin) Janos Huniadi. Me taktikat e tij ushtarake, Skenderbeu tërhoqi vëmendjen e komandatëve Otomanë dhe e la fushën ë bëtëjës për të shkur në Shqipëri me 300 kalorësit e tij besnikë. Pasi hynë në Shqipëri në mënyrë triumfuese, ata



sulmuan Kështjellën e bardhë të Krujës me 28 Nëntor 1443 duke larguar me forcë nga posti Guvernatorin Otoman. Për 25 vitet e ardhshme, Skenderbeu arriti fitore të mëdha ushtarake të cilat e mbrojtën Europen nga pushtimi Islam dhe Perandoria Osmane dhe do të hidhnin themelet për ndërtimin e shteteve të lira dhe demokratike.

Në vitin 1461, Mbreti i Napolit Ferdinandi i I, djali i të ndjerit Alfons, mik i ngushtë i Skenderbeut kërkoi ndihmën e Skenderbeut për të parandaluar një pushtim të mundshëm francez. Skenderbeu udhëhoqi një ushtri elitare prej 4000 kalorësish dhe i përndoqen francezet në betejën e famshme të Puglias afër Napolit. Si shpërblim për këtë fitore Ferdinandi i I i dha Skenderbeut dhe 2000 ushtarëve të tij tokë në fshatin malor të Grecit. Mbretëria u siguria më shumë kur Skenderbeu vendosi të lërë ushtrinë e tij në Greci, kurse ai u kthye në Shqipëri për të vazhduar të mbrojtë vendin e tij nga pushtimi Otoman. Vizitorët në Greci mund të shohin që rruga kryesore e Grecit është emërtuar *Via Skenderbeg-Rruga Skenderbeu* dhe së shtëpitë origjinale të trupave të Skenderbeut janë ruajtur, megjithëse ato kanë nevojë për restaurime.)


Vetëm pas vdekjes së Skenderbeut në 1468, Otomanët mundën përsëri të shkelin në Shqipëri



*Shirley Cloyes DioGuardi
në rrugë për Greci, Tetor 2003*

dhe i rimorën tokat shqiptare më 1480. Në atë kohë qindra dhe mijëra shqiptarë ikën përtej detit Adriatik për në Pernadorinë e Napolit dhe më tutje për të kërkuar liri nga sundimi turk dhe kthimit me forcë në fenë islame. Përveç Grecit, ata themeluan edhe 50 fshatra të tjera shqipfolëse që lulëzuan dhe u zhvilluan deri në ditët e sotme në, Campania, Puglia, Sicilia dhe Calabria. Refugjatët shqiptarë që u quajtën *Arbëresh* i ruajtën traditat, kulturën dhe gjuhën shqipe si dhe trashëgiminë katolike gjatë pushtimit Otoman të tokave shqiptare që zgjati për 425 vjet. (Duke filluar nga viti 1960, gjuhëtari Martin Camaj ka vizituar Grecin dhe ka studjuar e dokumentuar gjuhën shqipe të folur e të shkruar atje dhe e ka quajtur atë formën origjinale të gjuhës shqipe).

Kjo është arsyeja pse Arbëreshët vazhdojnë të jenë afër trojeve shqiptare, dhe gjithashtu t'i qëndrojnë përgjithmonë besnik Italisë. Pas rënies së Pernadorisë Otomane në vitin 1912, shqiptarët u gjenden përballë betejave pushtuese sllave duke filluar me luftërat Ballkanike 1912-1913. Me aprovimin e të ashtu quajturave Fuqi të Mëdha (Austro Hungaria, Britania, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia), shqiptarët i ndanë artificialisht dhe padrejtësisht. Vetëm pas ndërhyrjes së Presidentit Amerikan tv asaj kohe Woodrow Wilson në fund të Luftës së parë Botërore në vitin 1918 u formua shteti shqiptar. Tre million e gjysëm shqiptarë jetojnë sot në Shqipëri, tre million e gjysëm të tjerë jetojnë në shtetet kufizuese – në Kosovë (shtet i pavarur që nga viti 2008), Maqedoni, Mal i Zi, Lugina e Preshevës



(Serbi Jugore) dhe Çamëri (Greqi Veriore). Reth 8 milionë shqiptarë jetojnë në diasporë, kryesisht në SHBA, Europën Perëndimore, Turqi dhe Australi – të cilët kanë marrë arratinë nga terrorizmi i sponsorizuar i shteteve sllave dhe më vonë nga komunizmi, deri në shekullin e njëzet.

Fshati Greci ka një veçanti rreth të cilit shqiptarët anëkend botës janë të lidhur. Kur lind një fëmijë në një fshat shqiptar në Itali ai ngrihet në ajër në drejtim të Shqipërisë. Kur një fëmijë lind në ndonjë nga tokat shqiptare në Europen juglindore ose diasporë, ai ose ajo do të rritet duke mësuar për Skënderbeun dhe se Greci ishte i vetmi fshat shqipfolës në Italinë moderne që shkeli këmba e Skënderbeut.

Skënderbeu është heroi kombëtar që i bashkon të gjithë shqiptarët në një histori kombëtare ende të papërfunduar që filloi në Itali 600 vjet më parë.

18 Mars, 2015
Ossining, New York



Kisha e Shën Bartolomeut
e ndërtuar në shekullin e 17të



Vajza Arbëreshe në kostume kombëtare

Greci, Katundi – “Fshati i lindjes”, sikurse thirret në gjuhën e vendit, është i vetmi qytet në rajonin e Campanias që përfshin një komunitet Arbëresh, një minoritet gjuhësor etnik që ka jetuar në Itali që nga shekulli i 15të. Pozicionuar në Luginën e Cervaros, Greci u themelua në vitin 535 nga Perandori Justinian i cili luftoi në një betejë kundër Gotëve. Ai u shkatërrua nga Saracenët në vitin 908 dhe u rindërtua 80 vjet më vonë.

Në vitin 1461, Mbreti i Napolit Ferdinandi i I, djali i të ndjerit Alfons, mik i ngushtë i Skënderbeut, kërkoi ndihmën e Skënderbeut për të parandaluar një pushtim të mundshëm francez. Skënderbeu udhëhoqi një ushtri elitare prej 4000 kalorësish dhe i përdoqën francezët në betejën e famshme të Puglias afër Napolit. Si shpërblim për këtë fitore Ferdinadi I i dha Skënderbeut dhe 2000 ushtarëve të tij tokë në fshatin malor të Grecit.

Greci gjendet në kufirin e rajonit të Apulias, një zonë me bukuri të rrallë natyrore që laget nga lumi Cevalo. Shtëpitë karakteristike në Greci quhen “Halive” nga një fjalë e shqipës për kasollë. Këto shtëpi janë të bëra nga guri dhe gjenden kryesisht në lagjen Rione Breggio të Grecit. Kisha kryesore e Grecit i është dedikuar Apostulit Shën Bartolomeut, që karakterizohet nga një stil i thjeshtë oriental i arkitekturës romaneske, e modifikuar në shekullin e 17 për t’ju përshtatur ritit Latin.

Kisha e Zojës së Carosenes gjendet në hyrjen e qytetit dhe karakterizohet nga elteri i madh, e dominuar nga një statujë ikonë e Nënës së Zotit e quajtur Carusinus për nder të lidhjes me botën Greko Ortodokse. Mes ndërtesave në qytet, me rendësi të veçantë janë Pallati Lauda, një ndërtesë historike që nga shekulli i 18të, Pallati De Maio një ndërtesë e viteve 1700 që karakterizohet nga një derë e madhe me gurë dhe një ballkon në qendër të ndërtesës, Pallati Caccese një ndërtesë aristokrate që nga shekulli i 19të me një koleksion objektesh historike dhe kulturore të politikanit dhe dietarit të famshëm Giuseppe Vedovatto, Pallati Lusi në të cilin ndodhet Muzeumi PLEAG që nga viti 2009, një ekzpozitë arkeologjike me relike të zbuluara në atë zonë në 1999. Jashtë qytetit ndodhet Shatervani Masseria di Tre Fontane, një monument dhe stacion i vjetër që gjendet në një rrugë të vjetër në Camporeale-Foggia. Greci ka qenë gjithashtu vendbanim i familjeve Spinelli dhe Guevara.



Shtëpi të vjetra karakteristike në Greci



Muzeu arkeologjik në Greci



ÇFARË MUND TË VIZITONI NË GRECI

- Kishën e Shën Bartolemeut e ndër-tuar në shekullin 17^{is}
- Pallatin Caccese
- Pallatin Lusi nga shekulli i 18^{is} që sot është Bashkia e qytetit
- Pallati Lauda nga shekulli i 18^{is}
- Lagjen Rione Breggo me shtëpi tipike shqiptare



Hoteli Incontro, Ariano Irpino



Hoteli Fontana Del Re, Ariano Irpino



Agriturismo Arbëreshe, Greci

KU TË QËNDRONI DHE TË HANI?

—HOTELE—

HOTEL INCONTRO

Via Nazionale Manna,
83031 Ariano Irpino AV, Italy +39 0825 891857

HOTEL FONTANA DEL RE

Corso Vittorio Emanuele, 1 (locality Magdalene)
83031 Ariano Irpino (AV)

Tel.: +39 0825 827956 Fax: +39 0825 892139
www.fontanadelre.it, e-mail: info@fontanadelre.it

AGRITURISMO ARBARESHE

Contrada Macchia Piano, 61/a, 83030 Greci AV
tel.: +39 0825 867211;
12 beds, children's playground, mountain bikes,
bocce, restaurant for 50 persons

—RESTORANTE DHE PIZZERI—

Farm "THREE HILLS"

Via Turchiciello , 19-83031 Ariano Irpino (AV)
tel.: +39825827130

Regio Tratturo Contrada Camporeale

tel.: +39825881407; +393803976433

Tajuri Pizzeria

Via Garibaldi 18 83030 Greci
tel: +393398265909; +393470534998



SI MUND TË SHKONI NË GRECI:

- Me Makinë:** Nga autostrada veriore Ancona-Pescara, dilni në Foggia dhe ndiqni drejtimin për Napoli 50 km deri në Greci.
Me Tren: Nga Italia e veriut merrni trenin Milan-Lecce deri në Foggia. Nga atje mund të merrni një autobus për në Ariano Irpino.
Me Aeroplan: Mund të fluturonit deri në aeroportin e Napolit. Nga Napoli mund të merrni një autobus deri në Ariano Irpino.

Raport i vizites ne Greci

Të dashur miq të Grecit,

Përpara se të lëvizja për në Monaco, gjatë ditëve të para të Janarit të vitit 1961, në murin e dhomës së apartamentit tim të vjetër në periferi të Romës, kisha një hartë të fshatrave shqiptaro italiane në Italinë e Jugut. Unë kisha vendosur t'ja dedikoja një pjesë të jetës time studimit të gjuhës dhe zakoneve të arbëreshëve, të cilët jetonin në këto fshatra të përfaqësuara nga pika të kuqe në hartën që shtrihej nga Abruzzi në Sicili.

Sytë e mi shpesh ndalonin në një emër në hartë i izoluar diku në pjesën verilindore, në Greci. Meqë kisha kaluar më shumë se gjysmën e jetës time në Evropën Qendrore në Gjermani, nuk isha më supersticioz, kurse më 1958 kujtoja se kisha qenë. Shpesh i thosha vetes se nëse do të filloja studimet e mija në Greci "Nuk do të ndaloja në bujtinën e parë"

Mblodha informacion për Grecin nga biblioteka të ndryshme; nuk kishte shumë informacion sepse pak ishte shkruar për historinë e qytetit tonë. Unë zbulova se një shkrimtar të njohur, At Leonardo de Martino një prift franceskan që e kaloi gjithë jetën e tij në Shqipërinë e veriut si mësues e sidomos mësues i poetit të madh shqiptar Gjergj Fishta, ai ishte nga Greci. A ishte ky një emër apo një destinacion, kisha dëshirë të mendoja që ishte emri i Leonardo Di Martino që më bëri të filloj studimin për gjuhën e folur në Greci. Unë zgjodha Grecin megjithëse u dekurajova nga profesorët e universitetit tim në Romë, të njëjtët profesorë që më udhëhoqën në studimet e mia: Ernest Koliqi dhe gjuhëtari i njohur Antonio Pagliaro, të cilët dëshironin që unë të filloja studimin tim në fshatrat më në brendësi të Basilikates dhe pjesës së sipërme të Kalabrisë, si në Shën Konstantino Albanese, studim të cilin e mbarova muaj më parë, një studim për gramatikën që do të botohet së shpejti.

Më lejoni të shpreh dicka për vlerën atdhetare shpirtërore të Grecit. **Më lart unë fola për "specifikat kulturore" sepse edhe në lidhje me dialekte të tjera të arbërishtes "a la katunçe", Greci është unik në botë dhe në fakt në asnjë fshat nuk flitet ekzaktësisht si flitet në Greci.** Unë jam i gëzuar që kjo shtojcë në kulturën e Grecit arriti deri aty sa mua të më jepet qytetarit të nderit..


Por ka dhe një arsye tjetër që më jep kënaqësi të identifikohej me ju dhe është arsyeja më e natyrshme në botë: **Greci është një fshat shqiptar dhe unë jam Shqiptar.**

Martin Camaj, PhD

Letra e gjuhëtarit Martin Camaj i cili kaloi vite në Greci duke studiuar dhe dokumentuar atë që ai e quan formën më të mirë origjinale të shqipes, atë që flitet dhe shkruhet sot në Greci.

SHQIPTARËT ÇËSHTJE E PAZGJIDHUR

Botuar në revistën *National Geographic*
në numrin e muajit Shkurt të vitit 2000




Larja pranverore:

Valbona Parllaku nga fshati Novosellë (djathtas) duke festuar ditën e Shën Gjergjit në mënyrën tradicionale shqiptare—duke e larë vëllanë e saj, Arianin, me ujë nga lumi dhe me lule pranverore, e pastaj duke e fërkuar me vezë për fat të mirë.



Në kishën e Shna Nout në Laç (poshtë), shqiptarët mysliman dhe katolik besojnë se duke prekur muret dhe gurët e kishës, sjellin shëndet dhe mbarësi tek ta.



500 qind vjet më parë shqiptarët u larguan në drejtim te gadishullit Italian për të të kërkuar ndihmë e strehë nga fqinjët e tyre Italian. Bregdeti Italian ndodhet rreth 45 minuta nga Shqipëria nëpërmjet detit Adriatik. Gjatë kohës së komunizmit shqiptarët shihnin stacionet televizive italiane të cilat u jepnin në pasqyrë dhe shkëndija të shoqërisë së konsumit.

Në shekullin e 15të mijëra shqiptarë kristianë u larguan nëpërmjet detit Adriatik, ndërsa luftëtari shqiptar Skenderbeu luftonte për zbrapsjen e pushtuesve turq. Këta refugjatë të parë shqiptarë u quajtën Arbëresh dhe themeluan rreth 50 fshatra—disa nga të cilat ende ekzistojnë në Sicili, Kalabri, Kampania dhe Puglia.

Gjatë shekujve Arbëreshët kontribuan në jetën italiane me një pape, tre kardinalë, një kryeminister dhe një bureshtetas Francesco Crispi. Ata e ruajtën kulturën shqiptare gjatë sundimit Otoman dhe studiuesit e tyre ishin ndër të parët që ruajtën dhe shkruan gjuhën shqipe.

Nga Italia shqiptarët u shperndane anembanë botës. Në 1929 Giuseppe DioGuardi u largua nga fshati Arbëresh Greci për të shkuar në Bronx, New York ku hapi një dyqan me ushqime Italiane. Djali i tij i madh Joe, mendonte se ishte Italian. Vetëm kur u zgjodh në Kongresin Amerikan, ai mësoi për të kaluarën e tij. “Babai im ishte një njeri i thjeshtë. Ai kurrë nuk më kishte treguar më parë,” tregon DioGuardi. “Ai fliste me prindërit dhe motrat e tij në një gjuhë të cuditshme dhe unë mendoja se ishte një dialekt i italishtes.”

DioGuardi e “mori flamurin shqiptar” në mes të viteve tetëdhjetë dhe u bë njeriu kryesor për çështjen shqiptare në zonën e New Yorkut. Prillin e kaluar Liga Qytetare Shqiptaro Amerikane ndihmoi që të përcilleshin 385 shqiptaro amerikan të Brigadës Atlantiku për të luftuar me UCKnë.

DioGuardi dhe gruaja e tij Shirley ofruan të më shumë informacion për në Greci, një fshat i përhumbur në fushat e grunjeta të Camapnias. Pothuajse të vetëm shqipe-arbërishte që DioGuardi mban mend është shprehja “Gjaku i Shprishur” që do të thotë përafërsisht gjaku i shpërndarë. Një përsëritje magjike që ndricoi kaq shumë sy përqaftimi i DioGuardit me Giovanni Pucci, një shitës i dalë në pension me të cilin ishin të lidhur nga stërgjyshi.

“Unë mund të jem Amerikan me të dy prindërit nga Italia,” thotë DioGuardi, “por tani unë kam një zemër shqiptare.”

By Priit J. Vesilind

NATIONAL GEOGRAPHIC SENIOR WRITER

Photographs by Alexandra Boulat

Historia Shqiptarëve në Itali

RIGJETJA E RRËNJEVE TE MIA ITALIANE DHE SHQIPTARE HON. JOSEPH J. DIOGUARDI

Në vitin 1974 udhëtuam me babain tim në Greci, një fshat në majë të malit në afërsi të Napolit, nga i cili ai ishte larguar në vitin 1929 kur ishte 15 vjeç në kërkim të mundësive me të mira ekonomike. Ishte një eksperiencë shumë emocionale teksa e shihja babanë të emocionuar e me lot në sy teksa përshëndetjet në Italisht dhe Shqip me shokët e fëmijërisë dhe të afërmit, të cilët nuk i kishte parë për 45 vite.

Tetorin e kaluar, unë dhe gruaja ime Shirley udhëhoqëm një delegacion shqiptaro amerikanesh për të ndjekur një ceremoni nga papa John Paul II në Vatikan për të filluar procesin e shenjtërimin e Nënës Tereze. (Ajo është shqiptare etnike, lindur më 1910 në tokat shqiptare që tashmë janë pjesë e Republikës së Maqedonisë), ndërsa ishim në Itali vendosëm të kthehemi në Greci, qyteti me verior nga të 51 qytetet dhe fshatrat shqipfolëse në Itali, dhe i pari që u vendosën shqiptarët nga Ballkani në shekullin e 15të.

Tridhjetë vite pas vizitës sime në Greci, unë përsëri pash lot në sy teksa përshëndeteshim me pasardhësit e Gjergj Kastriotit, udhëheqësit të madh shqiptar që udhëhoqi ushtrinë shqiptare, në numra jo të barabartë, në luftë kundër ushtrisë Otomane për 27 vjet me rradhë duke shpëtuar gadishullin Italian nga pushtimi brutal që e pllakosi Shqipërinë për 450 vite.

Kastrioti dhe 4000 ushtarët e tij luftuan kundër Lombardëve të cilët erdhën nga jugu i Francës për të

ndaluar Mbretërinë e Napolit. Kjo ishte përsëritje e asaj që kishte ndodhur 18 vite më parë në 1443 kur Kastriotit iu kërkua nga Papa, Mbreti Alfons i Napolit dhe Mbreti Ferdinand i Spanjes për të përëndjekur Francezët.

Në 1461 Mbreti Alfons vendosi të shpërblente Kastriotin fitimtar dhe ushtarët e tij duke i falur një tokë në zonën e Grecit, që ndodhej në majë të malit më të lartë mes Napolit dhe Barit. Ideja e Mbretit Alfons ishte që Kastrioti t'i linte gjysmën e 4000 ushtarëve si shenjë sigurie për Gadishullin Italian në Mbretërinë e Napolit kundër sulmeve të mundshme nga Lombardët Francezë.

Kastrioti u kthye në Shqipëri për të luftuar kundër Turqve Otoman. Ai vdiq 7 vite më vonë më 1468 dhe nuk u kthye më në Greci. Ushtarët e tij nuk u kthyen me në Shqipëri e cila ishte pushtuar nga turqit në 1488 gjë që shkaktoi ikjen e qindra mijëra shqiptarëve nga Shqipëria në bregdetin lindor të Gadishullit Italian.

Rreth 550 vite pasi shqiptarët e parë nga Ballkani u vendosën afër Avellinos, delegacioni ynë u mirëprit në Greci nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak, priftërinjtë lokalë, banorë të fshatit ndër të tjerë edhe kushërinjtë të mi nga fisi Tozzi, familja e gjyshës sime dhe familja DioGuardi.

Në u pritëm me një mikpritje të rrallë shqiptaro italiane. Akoma mbaj në kujtesë kur dëgjoja gjuhën shqipe të folur Arbërishte, e cila është ruajtur në Greci për më se 5 shekuj.

Ne e kishim gjetur "gjakun e



Joe dhe Grace në kopertinën e revistës Grocer's, Bronx (1955)



Piknik familjar në plazhin Orchard Beach, Bronx (1946)

humbur" ose siç thoshte babai im "gjakun e shprishur". Ai e përmendte këtë në vitet 1940 dhe 1950 kur takonte të tjerë njerëz që flisnin Arbërishte ose siç e quanin shokët e mi në Bronx "Albanese" ose "Gheghere". Mbjaj mend shumë mirë ende lotët dhe përqafimet pasi i dëgjoja këto fjalë. Kjo është ajo që ndodhi kur delegacioni ynë shqiptaro amerikan u takua me motrat dhe vëllezërit tanë në Greci në 18 tetor 2003. Unë besoj që të gjithë anëtarët e delegacionit pësuan një rilindje kombëtare dhe kulturore dhe një rilidhje krenare me rrënjët historike shqiptare në Itali.

Udhëtimi në Greci filloi procesin e rilidhjes së shqiptarëve dhe shqiptaro amerikanëve me aleaten dhe miken Italinë.

Joseph DioGuardi është themeluesi dhe kryetari i Lidhjes Qytetare Shqiptaro Amerikane. Ai është anëtar i NIAF që nga viti 1978. Për më shumë informacion për shqiptarët në Itali vizitoni www.aacl.com. ■

PREMTIMI I AMERIKËS...

HISTORIA E FAMILJES DIOGUARDI




Giuseppe DioGuardi (1929)

MBËRRITJA NË AMERIKË

Ishte viti 1929, si mijëra emigrantë nga Italia, Giuseppe DioGuardi (Joe Sr), arriti në New York nga Greci, një fshat Arbëresh në provincën e Avelinos afër Napolit, me nënën dhe motrat e tij. Koha në të cilën erdhën koïncidoi për fat të keq me rënien e bursës së New Yorkut dhe me periudhën e depresionit të madh në Amerikë që patën pasoja në mundësitë ekonomike dhe thyen ëndrrat e mijëra të ardhurve të ri.

Vetëm me gjashtë vite shkollë dhe njëhjetë vitet e italishtes dhe shqipes, pesëmbëdhjetë vjeçari Joe Sr. ishte këmbëngulës që do të arrinte sukses në tokën e mundësive. Ai ecte në rrugët e pjesës përendimore të Manhattan-it dhe në Harlem dhe bënte punë të ndryshme. Ai kursente para dhe e dinte që ditë më të mira do të vinin për te.



Joe, Sr. në Victory Food Market në Bronx (1955)

ardhur në New York në vitin 1910 dhe ishin vendosur në pjesën lindore të Manhattan-it, nga Giovanazzo afër Barit.

Më 20 Shtator 1940 lindi fëmija i tyre i parë Joe. Dy fëmijët e tjerë vajza Angel lindi më 1942 dhe djali Richardi më 1945. Joe Jr., Angel dhe Dick e mësuan shumë shpejt biznesin familjar, ata shpërndanin ushqime, rregullonin raftet dhe punë të tjera në dyqan. Ata aty mësuan vlerat bazë të familjes së sotme – punë, respekt për prindërit, fëmijët dhe të moshuarit dhe një zell të madh për të pasur sukses, për të ëndërruar dhe planifikuar të ardhmen.



Joe, Jr. duke luajtur me fisarmonikë

Si fëmija më i madh, Joe Jr. (Babai i Kara's) mësonte shumë mirë. Ai ishte student model që fitonte çmime e lëvdata, pavarësisht orëve të gjata që punonte në biznesin e familjes pas shkolle dhe në fundjavë. Derisa fëmijët tjerë luanin jashtë, Joe ndihmonte prindërit e tij në dyqan, mësonte ose luante në fizarmonikë.



Giuseppe (Joe Sr.) DioGuardi New York City (1935)

FILLIMI I BIZNESIT TË VOGËL DHE FILLIMI I FAMILJES

Me paratë e kursyera me sakrificë të madhe, Joe Sr. hapi një dyqan me fruta perimesh në Harlem në vitin 1932. Më vonë më 1939, ai hapi një supermarket në Tremont Ave., dhe Crotona Ave., në pjesën e "Little Italy" në Bronx.

Pasi ishte stabilizuar mirë, Joe Sr. u martua me Grace Paparella, familja e së cilës kishte



Joe, Jr. si maturant në Fordham Prep. Bronx (1958)



Kara duke kënduar në një mbrëmje familjare Të dielen e Pashkëve (1977)

Sikurse paradhësit e mi arbëresh do të thonin, *"Po me besën ca na lanë e që kurrë u mek as pakë."* (They instilled solid values in us that have never faded.)

—Joe DioGuardi

STUDIM SERIOZ, SHUMË PUNË, DHE DISIPLINË

Në kërkim të një jete më të mirë për familjen e tij, Joe Sr. dhe Grace vendosën që të lëvizin familjen DioGuardi në zonën e Westchester në vitin 1957 kur Joe Jr. ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç. Joe, Angel dhe Dick vazhduan të punonin në dyqanin e familjes pas shkolle dhe gjatë pushimeve të verës.

Pasi mbaroi Fordham Prep në vitin 1958, Joe Jr. punonte gjatë verës dhe në fundjave si kamarier në Westchester për të paguar bursën për shkollimin e tij në Universitetin Fordham, të cilin e mbaroi për llogaritarr me rezultate të shkëlqyera.



Joe me gruan e parë (Carol) (vdiq më 1997) në shtëpinë e tyre në Wilmet Woods në New Rochelle me dy fëmijët, Kara 17 vjeçe dhe John 14 vjet (1987)



Kara në moshën 12 vjeçe, me aktoren Sofia Loren, Grand Marshall në vitin 1983, pas paraqitjes së saj në Waldorf Astoria



Joe me Kara dhe John me pushime në Ocala, Florida (1985)

Në vitin 1962 Joe iu bashkangjiti firmës ndërkombëtare të llogaritarrëve Arthur Andersen dhe më 1965 mori titullin Llogaritar të Certifikuar kurse në vitin 1972 u bë partner i firmës. Në vitin 1968 ai u martua me Carol Asselta dhe bënë dy fëmijë Kara dhe John. Pas 22 viteve në firmën prestigjioze, Joe u largua për të kandiduar në Kongresin Amerikan. Nga viti 1985 deri në vitin 1989 ai shërbeu si Kongresmen, përfaqësues i lartë në Kongresin Amerikan duke përfaqësuar zonën Westchester.

Pasi u largua nga Kongresi në vitin 1989, Joe themeloi Ligën dhe Fondacionin Qytetar Shqiptaro-Amerikan për të vazhduar punën e nisur për të ndihmuar shqiptarët në Europën Juglindore, punë të cilën e kishte nisur si kongresmen më 1986.

Në gusht të vitit 1997, Joe humbi gruan e parë pas një beteje të gjatë me kancerin. Në Qershor të vitit 1998, Joe u martua me botuesen, studiuesen e pavarur dhe aktivisten për të drejtat e njeriut Shirley Cloyes. Ajo është këshilltare për çështjet e Ballkanit dhe stratege politike e Ligës Shqiptaro-Amerikane që nga viti 1995. Shirley ka dëshmuar në seanca dëgjimore në Kongres sidomos në çështjen e Kosovës dhe ka shkruar shumë artikuj për çështjen kombëtare shqiptare gjatë këtyre 20 viteve.



Joe dhe Shirley DioGuardi, The Hotel Washington, 2000

Fotografia e mësipërme është marrë në një nga shumë vizitat e DioGuardit në Washington për të lobuar në Kongresin Amerikan dhe në Departmanetin e Shtetit për të drejtën e njohjes së vetevendosjes së shqiptarëve, veçanërisht të Kosovës, duke kuptuar problemet e tyre si një komb i lashtë prej 7 milionësh që jetojnë krah për krah, por të ndarë artificialisht me kufi të imponuar padrejtësisht pas Luftës së Parë Botërore.

JOSEPH J. DiGUARDI
20TH DISTRICT NEW YORK

COMMITTEE
BANKING, FINANCE AND
URBAN AFFAIRS

GOVERNMENT OPERATIONS

SELECT COMMITTEE ON NARCOTICS
ABUSE AND CONTROL

Congress of the United States
House of Representatives

Washington, DC 20515

WASHINGTON OFFICE
325 CANNON BUILDING
WASHINGTON, DC 20515
(202) 725-8504
DISTRICT OFFICE
1 NORTH BROADWAY SUITE
WHITE PLAINS, NY 10606
(914) 997-8440

February 24, 1988

At Antonio Bellusci
Via S. Lucia 20
871000 Cosenza, Italy

I dashur At Bellusci;

Më vjen keq që mu desh kaq kohë e gjatë për t'ju përgjigjur letrës tuaj të 20 nëntorit. Më duhej që ta përktheja letrën tuaj dhe dokumentet shtesë në anglisht dhe vetëm tani jam në gjendje të ulem e të shkruaj një përgjigje të menduar për letrën tuaj të mrekullueshme.

Siç keni kërkuar, unë po ju bashkangjis një biografi të shkurtër që flet për jetën time përpara vitit 1984 dhe disa nga gjërat që po bëj tani si kongresmen. Po ju bashkangjis gjithashtu një shkrim të titulluar "Premtimi i Amerikës - historia e familjes DiGuardi" e shkruar nga disa miq. Mund të botoni pjesë të zgjedhura nga ky shkrim në botimin e muajit prill të revistës "Lidhja".

Siç edhe e dini emri im DiGuardi ka kuptim shpirtëror. Zoti na ka mbrojtur mua dhe popullin shqiptar. Më 28 Gusht kur unë pata nderin të takohem me ju në restorantin e vogël në hyrje të Grecit para së të shkoja për të vizituar kushërinjtë e mi Arbëresh, ishte më shumë se një koincidencë që ju qëlluat të ishit në atë zonë, në të vetmen ditë që unë isha në Greci (në vend të shumë qyteteve Arbëreshe që iu përmendi në letrën tuaj).

Ju po bëni një punë të mrekullueshme për të mbajtur gjallë kulturën shqiptare për të ardhmen. Unë do të vazhdoj të mbështes përpjekjet tuaja dhe kohëve të fundit unë kam formuar një organizatë arsimore në Shtetet e Bashkuara që quhet "Fondacioni Etnik Kombëtar Shqiptaro Amerikan" për të ruajtur dhe kultivuar kulturën dhe vlerat tona këtu në Amerikë.

Ju falënderoj për fjalët e mira dhe për krahasimet e vlefshme të karakterit tim që vjen nga një familje me prindër Arbëreshë. Unë e kuptoj rëndësinë e veçantë të karakteristikave kulturore, pozitive të prejradhjes time Italiane, ashtu sikurse babai im që do të vazhdonte t'i prezantonte këto vlera këtu në Amerikë. Me vlerat tona nënkuptoj, dashurinë për Zotin dhe familjen, etikën e fortë të punës si dhe përgjegjësinë financiare (ne shqiptarët kursejmë përpara se të shpenzojmë - një gjë të tillë që duhet ta bëjnë me shumë Shtetet e Bashkuara dhe vendet e tjera).

Ju më kërkuat që unë t'ju jepja një raport nga vizita ime në Greci, atë çfarë ndjeva në zemër dhe çfarë më bëri të udhëtoj atje. Këto nuk mund të përshkruhen lehtë në një letër të shkurtër, po unë do të përpiqem t'i përshkruaj ndjenjat e bukura që pata kur udhëtova me makinë në ato male ku kishte lindur babai im dhe ku shqiptarët kishin ardhur 500 vjet më parë për të qenë të lirë.

Meqë kisha lexuar shumë për ate çfarë u kishte ndodhur vëllezërve dhe motarve tona në shekullin e 14të e 15të dhe më vonë, unë e dija që një vizitë në Greci do të më sillte më pranë njerëzve që luftuan kaq shumë me Skënderbeun, shumë shekuj më parë për të ruajtur lirinë dhe traditat e

tyre shqiptare. Është e mrekullueshme që 500 vite në Itali, nuk munden ta shkatërrojnë kulturën e fortë shqiptare që është e pranishme sot në Greci dhe që babai im e sollti me vete në Shtetet e Bashkuara në vitin 1929, kur u detyrua të largohej nga Greci i varfër ekonomikisht, në kërkim të kushteve më të mira ekonomike në Amerikë. Kjo flet qartë për kurajon dhe dashurinë që shqiptarët kanë në zemër, mendje edhe në shpirt, që për 500 vjet nuk harruan prejardhjen dhe kulturën dhe i trashëguan këto veti në zemrat dhe mendjet fëmijëve të tyre kudo që jetojnë nëpër botë. Unë jam një nga këta fëmijë, më i madhi i fëmijëve në familjen time, i lindur në një familje emigrantësh këtu në Amerikë, një vend i madh që më dha mundësinë të përparoj e të jem i sukseshëm, dhe të mund t'u rikthehem gjurmëve të babait dhe të gjyshit deri në kohën e Skënderbeut për të kuptuar më mirë se kush jam dhe sakrificat e mëdha që babai im dhe të parët tanë shqiptarë kanë kaluar, për të më dhënë mundësinë për të qenë sot në këtë vend të madh, si shqiptari i vetëm etnik në Kongresin Amerikan.

Kur filluam ti ngjiteshim malit të lartë për të shkuar në qyetetin e vogël Greci, me fëmijët e mi John, Kara dhe gruan time Carol, unë ndjeva diçka të çuditshme dhe të mrekullueshme që po shkoja në hapat e atyre që ishin larguar nga vendlindja 500 vite më parë për t'u treguar se përpjekjet e tyre nuk kishin shkuar kot.

Me duket si drejtësi paksa poetike që pas gjithë këtyre viteve një Kongresmen Amerikan me rrënjë shqiptare, të luftojë për të drejtat e shqiptarëve etnik dhe minoriteteve të tjera të vogla në të gjithë botën, sidomos në Kosovë. 500 vitet e fundit e kanë ndarë dhe nga një vend, nje fe, një gjuhë dhe një filozofi politike, janë bërë tre fe, të paktën pesë shtete dhe disa filozofi politike. Falënderojmë Zotin që akoma kemi një kulturë me tradita të lashta llires që i kanë mbijetuar kohës.

Ajo çfarë më bën më shumë krenar për prejardhjen time shqiptare, është që jam dëshmitar i asaj që shqiptaro amerikanët po bëjnë sot në Shtetet e Bashkuara. Karakteristikat kulturore që i përmenda më sipër janë shumë të rëndësishme për të gjithë shqiptarët katolikë, shqiptarët otodoksë apo myslimanë, shqiptarët besojnë në Zot dhe kanë besim tek vetvetja. Ata kanë familje të mëdha e të bukura edhe këtu në Amerikë dhe i respektojnë brezat më të vjetër. Ata e duan punën, janë krenar për punën e tyre dhe arritjet dhe kontribuojnë që edhe fëmijët e tyre të jenë krenar me ato që kanë arritur ndpërmjet duarve dhe mendjeve të tyre. Së fundi, jam i habitur se si familjet shqiptare duke përfshirë dhe babain tim, kursejnë për të ardhmen për fëmijët dhe familjet e tyre. Këto karakteristika unë do të vazhdoj t'i shpalos si shqiptar etnik, për t'i bërë me dije botës se shqiptarët kanë shumë për të dhënë si njerëz të Zotit, punëtorë, me dashuri për familjen dhe që do të vazhdojnë të kontribuojnë botës dhe gjithë njerëzimit.

Unë shpresoj që këto mendime janë ato çfarë pristnit dhe çfarë ju duhej. Vazhdoni me punën e shkëlqyer që po bëni për të ruajtur kulturën e paraardhësve tanë. Shpresoj që do të shihemi shumë shpejt përsëri. Unë planifikoj të vij në Romë me një grup Shqiptaro Amerikanësh në fillim të Majit dhe do të përpiqemi të vizitojmë Grecin. Do t'ju jap më shumë të dhëna që edhe ju të mund të na bashkangjiteni. Shpresoj që ju të vizitoni Amerikën ashtu siç e përmendet në letrën tuaj, që të mund të organizojmë një event që të mund të takoni vëllezërit dhe motrat tuaja shqiptarë në këtë vend të madh për shqiptarët dhe njerëz të tjerë të vullnetit të mirë.

Përshendetje të ngrohta,


Joseph J. DioGuardi

JJD/vh

Enclosures (2)

DISA NGA ITALIANO ARBËRESHËT E FAMSHËM



Giorgio Basra (Gjergj Bashta) (1544-1607) ishte një Gjeneral Italian me prejardhje Arbëreshe, i cili u punësua nga Perandori Rudolf II për të komanduar forcat Habsburg në Luftën e Gjatë 1591-1606 dhe më vonë ishte Administrator i Transilvanisë si ndihmës i Perandorit për të rivendosur katolicizmin si fe kryesore në Transilvani.



Papa Klementi XI (23 Korrik 1649-19 Mars 1721) lindi me emrin Giovanni Francesco Albani, shërbeu si Papë nga viti 1700 deri sa vdiq në vitin 1721. Albani lindi në Urbino, në një familje me zë që ishte vendosur atje nga Shqipëria e Veriut në shekullin e 15të dhe ishin ushtarë të Skënderbeut kundër Perandorisë Otomane. Gjatë kohës që ai ishte Papë, u krijua "Illyricum Sacrum" një nga bazat kryesore të studimit të Albanologjisë, një dokument me 5000 faqe i ndarë në vëllime shkruar nga Daniele Farlati dhe Dom Coletti. Ai ishte Guvernator i Rietiut dhe Urbinos dhe Kardinal Diakon i S. Maria në Aquiro shpallur nga Papa Aleksandri VIII, pas të cilit u emërua Papë në 23 Nëntor, 1700.



Nicola Chetta, Arbëreshi Nikollë Keta (1740-1803) ishte një shkrimtar dhe poet Italian me origjinë shqiptare. Ai lindi në fshatin Kundsia në Sicili, një vendbanim shqiptarësh i themeluar në vitin 1450 dhe 1467. Ai u shkollua në Seminarin Grek në Palermo. Në vitin 1777 Keta u bë Rektor i Seminarit. Ai shkroi poezi fetare dhe jo fetare në shqip dhe greqisht dhe kompozoi Soneten e parë shqiptare në 1777

Gulio Variboba (1725-1788) Arbëreshi Jul Variboba ishte një poet që ka dhënë kontribut të rëndësishëm në letërsinë shqiptare. Variboba u pagëzua me emrin San Giorgio Albanese në provincën e Kozencës, nga një familje shqiptare nga Mallakastra një rajon në Shqipërinë e Jugut. Ai studioi në Seminarin e Korsinit në San Benedetto, Uliano, një qendër për edukimin dhe trajnimin e priftërijeve Grek bizantin.

Ky Seminar u themelua në 1732 nga Papa Klementi XII dhe pati një impakt në zhvillimin kulturor të Arbëreshëve të Kalabrisë në shekullin e 18të, të njëjtë me atë të Seminarit Grek të Palermos për Arbëreshet e Sicilisë. Variboba ishte një nga studentët e parë që u bë prift në vitin 1749 dhe u kthye në San Giorgio për të ndihmuar babain e tij që ishte prift i fshatit. Gjatë studimeve në seminarin Korsini, Variboba tregoi epërsi dhe preferencë në përdorimin e ritit katolik Latin, karshi ritit bizant grek në kishën Arbëreshe. Në vitet në vazhdim polemikat e tij në mbështetje të konvertimit në ritin Latin bënë që t'i binte popullariteti në kishën e tij dhe në hierarkinë e kishës në Rossano, veçanërisht ndaj apelit që i bëri direkt Papës. Ai u detyrua të largohet nga fshatin i tij, më vonë u detyrua të linte Campanian dhe Napolin dhe në 1761 u vendos në Romë derisa vdiq.



Demetrio Camarda, Lindur Dhimitër Kamarda në Piana Degli Albanaesi në 1821 dhe vdiq në Livorno në 1882, ishte një gjuhëtar dhe patriot Arbëresh, botues i folklorit shqiptar me njohuri shkencore në fushën e gjuhëve Indo Europiane. Ai ishte vazhduesi i punës së Jeronim De Rades. Puna e tij kryesore "Teksti Krahasesues i Gramatikës së Gjuhës Shqipe" ishte i pari studim shkencor krahasesues në këtë çështje. Ai dha kontribut të rëndësishëm me botimin e Alfabetit në 1869.



Luca Matranga - Lekë Matrënga lindi në Piana degli Albanesi në 1567 dhe vdiq në 1619. Ai ishte një shkrimtar dhe prift Arbëresh nga Sicilia dhe njihet si një nga shkrimtarët e parë të gjuhës shqipe.

Matrënga është përkthyesi i librit të katekizmit "E Mbesueme e Krishterë" nga Latinishtja në Shqipen mesjetare. Libri u botua në Romë në vitin 1592 dhe kishte 28 faqe. Parathënia e librit është në Italisht. Libri mbulon çështje të doktrinës kristjane dhe përfshinë edhe një poeme 8 vargëshe.

Rëndësia e këtij libri në letërsinë shqipe qëndron në faktin se ishte libri i dytë më i madh i botuar në shqip dhe se poezia e tij është nga të parat në shqip.



Girolamo De Rada – Jeronim De Rada (1814-1903) ishte një shkrimtar Italian me origjinë shqiptare. Ai ishte figura më kryesore e Rilindjes Kombëtare Shqiptare në Itali në shekullin e 19të.

Francesco Crispi - Lindi në Ribera më 4 Tetor 1819 dhe vdiq në Napoli më 11 Gusht 1901, ai ishte një politikan italian i shekullit të 19të me prejardhje Arbëreshe dhe kontribues në bashkimin e Italisë. Ishte Kryeministri i 17të dhe 20 të Italisë nga 1887 deri në 1891 dhe përsëri nga 1893 deri në 1896.

Gjyshi tij nga babai i vinte nga një fshat bujqësor në Komunën e Palazzo Adriano's në jugpërqendrim të Sicilisë. Më vonë u bë e ditur nga katolikë shqiptar, se ata ishin Arbëresh të vendosur në Sicili pas pushtimit Otoman të Shqipërisë. Crispi kishte lindur në Ribera në Sicili dhe ishte pagëzuar në Kishën Katolike Shqiptaro Italiane.



Nicola Barbato – Lindi në Piana del Greci në 1856 dhe vdiq në Milano në 23 Maj. Ai ishte një Arbëresh dhe politikan socialist. Ai ishte një nga udhëheqësit kombëtar të Lidhjes Siciliane, një lëvizje popullore dhe demokratike nga vitet 1891-1894, ndoshta nga më të zotët sipas historianit Marksist Eric Hobsbawm.

Franseco Antonio Santori – Francesk Anton Santori, lindi më 16 Shtator 1819 dhe vdiq në 7 Shtator 1894, i njohur dhe si Ndon Santori, ai ishte një shkrimtar, poet dhe dramaturg Arbëresh. Drama e tij Emira konsiderohet si drama e parë origjinale Arbëreshe.

DISA NGA ITALIANO ARBËRESHËT E FAMSHËM

Giuseppe Serembe – Zef Serembe lindi në 6 Mars 1844 dhe vdiq në vitin 1901. Ai ishte poet lirik dhe ka lënë disa nga përmbledhje me poezi më të mira në gjuhën shqipe të shekullit të 19të. Zhgënjimi dhe tragjedia që e ndoqën gjatë gjithë jetës së tij, janë të pranishme dhe në vargjet e tij.



Antonio Gramsci – Lindi me 22 Janar 1891 dhe vdiq më 27 Prill 1937, ai ishte një shkrimtar, politikan, filozof dhe gjuhëtar me prejardhje arbëreshe. Ai ishte një nga themeluesit dhe udhëheqës i Partisë Komuniste Italiane dhe u burgos nga regjimi fashist i Benito Mussolit. Gramsci ishte një nga mendimtarët më të rëndësishëm Marksist të shekullit të 20të. Shkrimet e tij përmbajnë analiza të kulturës dhe udhëheqjes politike. Ai njihet si mendimtar original në fushën e mendimit modern Europian dhe për konceptin e hegjemonisë kulturore si mjet për të mbajtur shtetin në shoqërinë kapitaliste.



Giuseppe Schiro – Zef Skiroi lindi në Piana dei Greci më 10 Gusht 1865 dhe vdiq në Napoli me 17 Nëntor 1925, ishte një poet neo klasik, gjuhëtar, publicist dhe mbledhës folklori nga Sicilia. Vepra e tij shënoi kalimin në letërsinë moderne shqiptare në Itali. Ai studioi Drejtësinë në Seminarin Arbëresh të Palermos. Në pjesën e parë të krijimtarisë së tij letrare ai trajtoi temën patriotike të traditave Arbëreshe. Ai është autor i poezive *Mili*, *Hajdhia* si dhe *Këngët e Likorit*, *Në dhe të huaj*, *Këngë Popullore Shqiptare*.



Ernesto Sabato – Lindi në 24 Qershor 1911 dhe vdiq në 30 prill 2011. Ai ishte një shkrimtar argjentinas, piktor dhe fizikan. Sipas BBC, ai ka fituar disa nga çmimet më prestigjioze në letërsinë hispanike dhe kishte shumë influencë në historinë botërore në Amerikën Latine. Pas vdekjes së tij ai u shpall "Shkrimtari i fundit klasik në letërsinë Argentinase". Ai lindi në Rojas në Argjentinë dhe ishte i biri i Francesco dhe Giovana Maria Ferrari, emigrantë italianë nga Kalabria. Babai i tij ishte nga Fuskaldo dhe nëna Arbëreshe nga San Marino di Finita. Ai ishte fëmija i dhjetë nga 11 fëmijët e familjes dhe lindi pasi i nëntë dhe mban emrin e tij Ernesto.

Sal F. Albanese, lindi në 29 Gusht 1949, ai është një politikan në New York që ka shërbyer në Këshillin Bashkiak të New Yorkut dhe ka kandiduar por pa sukses për poste politike në Asambelenë e New Yorkut, në Kongresin Amerikan dhe si Kryetar i Bashkisë së New Yorkut.



Regis Francis Xavier Philbin – Lindi në 25 Gusht 1931, ai është një personalitet në median amerikane, aktor dhe këngëtar, i njohur për prezantimin emisioneve argëtuese që nga viti 1960. Philbin lindi në New York City. Babai i tij Francis "Frank" Philbin, një officer i marinës amerikane i cili shërbeu në Paqësor, ishte me origjinë nga Irlanda. Nëna e tij Filomena "Florence" Boscia është me origjinë arbëreshe nga **Katundi, Greci**.



Joseph J. DiGuardi, lindi në 20 Shtator 1940 është një Llogaritar i Certifikuar Publik dhe politikan republikan. DiGuardi ka qenë Përfaqësues në Kongresin Amerikan dhe ka përfaqësuar Distriktin e 20të të New Yorkut nga viti 1985 deri në vitin 1989. Ai gjithashtu ka kandiduar për Senatn Amerikan në zonën e New Yorkut, por humbi ndaj Senatores Kirsten Gillibrand. DiGuardi ka qenë partner në kompaninë Arthur Anderson & Co., dhe është themeluesi dhe presidenti i Ligës Qytetare Shqiptaro Amerikane, një organizatë që e udhëheq me gruan e tij Shirley Cloyes DiGuardi, e cila është edhe këshilltare për çështjet e Ballkanit që nga viti 1995. Babai i DiGuardit Joseph Sr. emigroi në Shtetet e Bashkuara kur ishte 15 vjeç, nga fshati Arbëresh Greci në Itali. Më vonë në vitin 1939, ai hapi një dyqan frutash dhe perimesh në zonën Italiane të Bronxit. Familja e tij nga viti 1957 jetoi në zonën e Westchesterit.



James Joseph Schiro – Lindi me 2 Janar 1946 dhe vdiq me 13 Gusht 2014, ai ishte një biznesmen amerikan që u bë president i PriceWaterhouseCoopers dhe Zurich Financial Services. Ai ishte gjithashtu drejtor i kompanive të tjera të mëdha si Pepsico, Philips dhe Goldman Sachs. Schiro ishte me prejardhje Italo Shqiptare, Arbëreshe nga Sicilia. Ai diplomoi për shkencë në Universitetin St. Johns në New York në vitin 1967, doktoroi në Tuck School of Business në Kolegjin Dartmouth.

Kara Elizabeth DioGuardi – Lindi më 9 Dhjetor 1970, ajo është shkruese tekstesh këngësh, producente muzikore, kompozitore dhe personalitet televiziv. Ajo komponon në zhanrin pop rock. DioGuardi ka punuar me shumë artistë të famshëm dhe shijet e albumeve me këngët e saj i kanë kaluar 160 milionë dollarë në të gjithë botën.



DioGuardi është nominuar për çmimin Grammy, në 2011 ishte fituese e NAMM Music for Life, në 2009 ishte fituese NMPA për çmimin për këngë shkruese, në 2007 u nderua me çmimin BMI këngë shkruesën e vitit dhe ka marrë 19 çmime BMI për këngët që ka shkruar që kanë qenë më të dëgjura në radio. Ajo ka qenë në panelin e American Idol në sezonin e 8të dhe të 9të. Në vitin 2008 DioGuardi u emërua Zëvendës Presidente Ekzekutive për Zhvillimin e Talenteve në kompaninë Warner Brothers dhe ka nënshkruar kontrata me Jason Derulo dhe lyaz.

Carmine Abata – Lindi me 24 Tetor 1954, Ai është një shkrimtar Italian që ka shkruar tregime të shkurtra, romane, prozë dhe publicistikë të bazuara në çështjet e migrimit dhe ndryshimet midis kulturave të ndryshme. Abata e kaloi fëmijërinë në fshatin Carfizzi, një fshat i vogël Arbëresh në rajonin jugor të Kalabrisë. Ai fliste Arbërisht, një formë e gjuhës shqipe, që kur ishte i vogël. Pasi mbaroi studimet në Universitetin e Barit, ai shkoi për të jetuar në Hamburg ku kishte emigruar dhe babai i tij.

